



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	26.10.2023	30.10.2023	2023/0800

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.10.2023, OE “**ARCH EMPIRE L.L.C.**” ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0800**, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**SHËRBIME PROFESIONALE INXHINIERIKE -Ritender**” me nr. të prokurimit: “**214-23-6903-2-2-1**”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **90,000.00 €**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

AK ka shkelur dispozitat e LPP ne:

Neni 1 Qëllimi

Neni 2 Fushëveprimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tendereve

Neni 60 Kriteret për dhenein e kontratës

Neni 61 Tenderet Jo-Normalisht te Ulet

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

AK, me date 27.09.2023 ka publikuar njoftimin për vendimin e AK-se lidhur me procedurën e prokurimit me titull: SHËRBIME PROFESIONALE INXHINIERIKE, me numër prokurimi 214-23- 1131- 2-2-1, njëkohësisht AK ka ngarkuar në sitimin e-prurimi edhe letrat standarde për Eliminim të OE -ve. Përkunder faktit që në këtë procedurë prokurimi kanë aplikuar gjithsejt pesë ofrues shih Proces verbalin AK ka zgjedhur të anuloi procedurën e prokurimit me arsyetimet të veqanta për secilin OE apo grup të OE-ve. Në mesin e grupit të OE -ve të eliminuara është edhe grupi yne i OE Arch Empire LLC dhe Eng Idea shpk. E kemi lexuar me shumë kujdes arsyen e eliminimit të grutit të OE-ve dhe nuk pajtohemi me vendimin e komisionit të AK-se. Për këtë kemi bërë edhe kërkesë për rishqyrtim pranë AK-se me datë 01.10.2023. Përgjigjen për kërkesën tonë për Rishqyrtim AK e ka publikuar me 05.10.2023 duke e refuzuar si të pabazuar.

Pretendimi 1: Grupi yne i OE-ve “Arch Empire LLC” dhe “Eng Idea” shpk është marrë vendim të eliminohet me arsyetimin si në vijim:

Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:

- AK ka kërkuar që OE duhet të ketë pajisje për matje gjeodezike GPS. Të dëshmuar me Çertifikatë të kalibrimit nga kompania e licencuar për kalibrim – valide. Në këtë rast OE certifikatën e kalibrimit nuk e ka ofruar valide.

Në fazën e aplikimit në kemi ofruar pajisjen e kërkuar GPS GNSS Rover Kopos me gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kërkesat në dosjen e tenderit, përfshi certifikimin e kalibrimit nga kompania e licencuar për kalibrim AGEO & CO shpk - valide. Certifikata e kalibrimit mban datën e certifikimit 19.05.2022. Certifikimi i instrumenteve gjeodezike bëhet në periudha periodike të rregullta në maksimum çdo dy vite, andaj dhe certifikata e ofruar është valide, Pra, nuk qëndron pretendimi i komisionit të AK-se se certifikatë e kalibrimit nuk është valide të cilën gjë AK e perserit edhe në përgjigjen e kërkesës për Rivlersim! Nëse Komisioni i AK-se ka pasur paqartësi lidhur me validitetin është dashur të shfrytëzojë nenin 72 të LPP-se për të kërkuar sqarime që nuk e ka bërë! Në këtë rast edhe pse kemi bashkangjitur rregullorenë AKK-se për kalibrimin e instrumenteve AK nuk e merr fare në konsideratë!

Bashkangjitur gjeni dokumentin Në mbështetje të paragrafit 6 të nenit 4 dhe paragrafit 2 të nenit 34 të Ligjit Nr. 04/L-013 për Kadastër, paragrafit 5 të nenit 6 dhe paragrafit 5 të nenit 9 të Udhëzimit Administrativ MMPH – Nr. 12/19 për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës, paragrafi 5 të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ MMPH – Nr. 11/19 për ndarjen e ndërtesës dhe të pjesës së ndërtesës dhe paragrafi 3 të nenit 7 të Udhëzimit Administrativ MMPH – Nr. 10/19 për matjet kadastrale për regjistrim në kadastër, Agjencia Kadastrale e Kosovës nxjerrë këtë: Kornizë të punës Nr. AKK 2020/01 për matje, krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale (parcelë, ndërtesë dhe pjesë të ndërtesës), në të cilën pika 20 fletë qarte për Certifikimin e instrumenteve gjeodezike.

20. Certifikimi i instrumenteve gjeodezike

Për matje kadastrale mund të përdoren vetëm instrumente të certifikuara. Certifikimi i

instrumenteve matëse duhet të bëhet nga institucioni apo kompania e autorizuar prej prodhuesit të instrumentit. Vërtetimi/certifikatat për instrumentin nuk duhet të jetë më e vjetër se dy vite. Instrumentet për matjet kadastrale të cilat duhet certifikuar janë:

1. Instrumentet GNSS dhe

2. Stacion Total.

Gjeodetët e licencuar, kompanitë gjeodete të licencuara dhe tekniku gjeodet i licencuar janë të obliguar që pas dy viteve pasi që është bërë certifikimi i instrumenteve, të njëjtën gjë ta përsërisin dhe certifikatën e re ta dorëzojnë në AKK tek komisioni për licencim. Në të kundër, d.m.th. nëse nga gjeodetët e licencuar, kompanitë gjeodete të licencuara dhe tekniku gjeodet i licencuar nuk dorëzohet dëshmia për përsëritjen e certifikimit në afatin e caktuar, atëherë automatikisht konsiderohet e pezulluar licenca e tyre deri në plotësimin e kriterit të ricertifikimit. Pra, kjo deshmim me se miri që arsyeshmeria e Komisionit të AK për eliminimin e grupit të OE-ve Arch Empire LLC dhe Eng Idea shpk është në kundërshtim të plotë me ligjet, rregulloret dhe udhëzimet administrative. Pra kjo arsyeshmeri për eliminim është e pasakt dhe e paqëndrueshme. Megjithatë Ak përkundrazi deshmim dhe faktit të bashangjitur nuk merr fare në konsideratë dhe kërkesën për rivlerësim e refuzon!

Pretendimi 2: AK ka eliminuar të gjithë OE-të me arsye të caktuara po në do të ndalemi tek dy OE Eng group shpk dhe N.SH. GEO-MAP që kanë çmime dukshëm më të lira se grupi i Arch Empire LLC dhe Eng Idea shpk. Po ju rikujtojmë se vendimi për anulim i të njëjtes procedure prokurimi me titull: SHËRBIME PROFESIONALE INXHINIERIKE -Ritender, tani me është marrë për herë të tretë nga AK, pra dy herë më parë është anuluar kjo procedure e prokurimit për shërbime të lartecaktuara. Anulimi i kësaj procedure të prokurimit me datë 21.06.2023 ka ndodhur mbështetur edhe në vendimin e OSHP-se nr. 2023 0291. Arsyeja e anulimit të procedureve të lartecaktuara është bërë nga AK me arsyen si më poshtë:

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Policia e Kosovës anulon³ aktivitetin e prokurimit arsyetimin si në vijim: Çmimet e peshuara të ofruara nga të dy OE kanë qenë çmime abnormalisht të ulta se çmimet e planifikuara e të peshuara nga AK.

Data: 02/05/2023

Emri dhe mbiemri i ZPP: 

U be i gjithë ky sqarim me siper pasi që AK në këtë rast nuk ka marrë fare në konsideratë çmimet jonormalisht të ulta të ofruara nga të dy OE-të Eng group shpk dhe N.SH. GEO-MAP. Në njoftimin e vendimit të AK-se se të datës 27.09.2023 janë dhënë arsyetimet e eliminimit të të dy OE të lartecaktuara por nuk është përfshirë fakti që këta OE përveq arsyeve të dhëna nga AK kanë ofruar po ashtu çmime jonormalisht të ulta.

Pas qasjes në dokumentacion ku janë verifikuar dhe çmimet e ofruara nga të dy OE Eng group shpk dhe N.SH. GEO-MAP, përveq se vërtetohet se kanë ofruar çmime jonormalisht të ulta në ofertat e tyre ka dhe çmime abuzive.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “ARCH EMPIRE L.L.C.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “SHËRBIME PROFESIONALE INXHINIERIKE -Ritender” me numër të prokurimit: “214-23-6903-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS

Sqarim: OE GEO MAP ne poz.1 Pika A Hartimi i projekteve ideore jep cmimin 5.00 € , ndersa te gjitha cmimet e tjera perfshi çmimet ne piken B hrtimi i projekteve kryesore-palir ofron çmime jonormalisht të ulëta.

Hartimi i projekteve për nevoja të PK-se					
Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Shuma
A Hartimi i projekteve ideore - duke përfshirë edhe ingjizimin e gjendjes ne teren.					
10%					
1	Punimi i projektit ideor - arkitektura, organizimi dhe funksionaliteti i objektit.	m ²	1	5.00 €	5.00 €
2	Punimi i projektit ideor - faza e Statikës (konstruksioni dhe stabiliteti i objektit)	m ²	1	0.04 €	0.04 €
3	Punimi i projektit ideor faza e Hidroinstalimeve –(rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit).	m ³	1	0.04 €	0.04 €
4	Punimi i projektit ideor faza e instalimeve elektrike - energjetika, instalimi i rrymave të dobëta dhe të forta, rufembrojtësit, alarmet elektronike kundër zjarrit, LAN,IT, TV, BMS, Video monitorimi, Interfonia.	m ³	1	0.04 €	0.04 €
5	Punimi i projektit ideor faza e instalimeve makinerike – instalimet ngrohjes së objektit, stacionet termike, klimatizimi, ventilimi dhe instalime tjera makinerike.	m ³	1	0.04 €	0.04 €
6	Punimi i projektit ideor – RREGULLIMI I PARTEREVE / duke përfshirë edhe ingjizimin e gjendjes ne teren.	m ²	1	0.04 €	0.04 €
TOTALI A :(1 deri 6)					5.20 €
B Hartimi i projekteve kryesore - palir - duke përfshirë edhe ingjizimin e gjendjes ne teren.					
50%					
1	Punimi i projektit kryesor - Arkitektura, organizimi dhe funksionaliteti i objektit.	m ²	1	0.05 €	0.05 €
2	Punimi i projektit kryesor - Konstruksioni dhe stabiliteti i objektit (Ilogaria statike).	m ²	1	0.05 €	0.05 €
3	Punimi i projektit kryesor - Shkallevë emërgjente te objekteve nga konstruksioni i çelikut apo betonit.	cope	1	0.05 €	0.05 €
4	Punimi i projektit kryesor të Hidroinstalimeve - ujësjellësi, kanalizimi.	m ²	1	0.05 €	0.05 €
5	Punimi i projektit kryesor të instalimeve elektrike - energjetika instalimi i rrymave të dobëta dhe të forta, rufembrojtësit, alarmet elektronike kundër zjarrit, LAN,IT, TV, BMS, Video monitorimi, Interfonia.	m ²	1	0.05 €	0.05 €
6	Punimi i projektit kryesor të instalimeve elektrike - Trafove.	cope	1	0.05 €	0.05 €
7	Punimi i projektit kryesor të instalimeve makinerike - instalimet ngrohjes së objektit, stacionet termike , klimatizimi, ventilimi dhe instalime tjera makinerike	m ²	1	0.05 €	0.05 €
8	Punimi i projektit kryesor të instalimeve - Ashensoreve te ndryshem	cope	1	0.05 €	0.05 €
9	Punimi i projektit kryesor – RREGULLIMI I PARTEREVE. / duke përfshirë edhe ingjizimin e gjendjes ne teren.	m ²	1	0.05 €	0.05 €
10	Punimi i projektit kryesor – Rrenimi i objekteve.	m ²	1	0.05 €	0.05 €
TOTALI B :(1 deri 10)					0.50 €

Egziston rreziku potencial qe ky OE te punoj vetem projektin ideor te kerkoj aprovimin e ketij projekti dhe te kerkoj pagesen per hartimin e projektit ideor (qe do ti takonte me ligj nese nenshkruset kontrata) duke mos punuar fare me projektin kryesor. Pra, kjo menyre e ofrimit te cmimit eshte plotesisht abuzive dhe ne disproporcin te plote me cmimet e tregut.

Po ashtu ne poz. 1 pika C Hartimi i prejekteve per renovim OE NSH GEO MAP ofron çmim plotesisht te pakuptimt apo abuziv.

Egziston rreziku potencial qe ky OE te punoj vetem incizimin e objektit per renovim te kerkoj aprovimin e ketyre matjeve -incizimeve dhe te kerkoj pagesen per Incizimin detal te Arkitektures se objekti egzistues (qe do ti takonte me ligj nese nenshkruset kontrata) duke mos punuar fare me projektin kryesor per renovim. Pra, kjo menyre e ofrimit te cmimit eshte plotesisht abuzive dhe ne disproporcin te plote me cmimet e tregut.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “ARCH EMPIRE L.L.C.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “SHËRBIME PROFESIONALE INXHINIERIKE -Ritender” me numër të prokurimit: “214-23-6903-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS

C	Hartimi i projekteve për renovim - duke përfshi edhe inxhizimin e gjendjes në teren.	10%			
1	Inxhizimi detaj i objekteve ekzistuese (arkitektura), përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet ekzistuese, pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik.	m ²	1	4.00 €	4.00 €
2	Inxhizimi detaj i objekteve egzistuese-STATIKA, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet egzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik.	m ²	1	0.05 €	0.05 €
3	Inxhizimi detaj i objekteve egzistuese-ELEKTRIKA, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet egzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik.	m ²	1	0.05 €	0.05 €
4	Inxhizimi detaj i objekteve egzistuese-MAKINERIA, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet egzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik.	m ²	1	0.05 €	0.05 €
5	Inxhizimi detaj i objekteve egzistuese-UJESJELLESIT DHE KANALIZIMI, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet egzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik.	m ²	1	0.05 €	0.05 €
6	Inxhizimi i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet egzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik.	M ¹	1	0.05 €	0.05 €
7	Inxhizimi i rrjetit të jashtëm të kanalizimit, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet egzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik.	M ¹	1	0.05 €	0.05 €
8	Punimi i projektit renovues – ARKITEKTURA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m ²	1	0.05 €	0.05 €
9	Punimi i projektit renovues – STATIKA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m ²	1	0.05 €	0.05 €
10	Punimi i projektit renovues – ELEKTRIKA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m ²	1	0.05 €	0.05 €
11	Punimi i projektit renovues – HIDROINSTALIMET, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m ²	1	0.05 €	0.05 €
12	Punimi i projektit renovues – NGROHJA QENDRORE, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m ²	1	0.05 €	0.05 €
13	Punimi i projektit renovues të infrastrukturës – rrjet furnizues i ujësjellësit dhe përmbajtjeve përcjellese.	m ¹	1	0.05 €	0.05 €
14	Punimi i projekteve renovues të infrastrukturës – rrjet i kanalizimit dhe përmbajtjeve përcjellese.	m ¹	1	0.05 €	0.05 €
TOTALI C:(1 deri 14)					4.65 €

Ngjashem ka vepruar edhe OE Eng Group shpk duke ofruar çmim vetem ne poz. 1 Pika A dhe B. Pra ne cmim duke përfshi vetem arkitekturen projekt ideor dhe projekt kryesor 0.22+0.45 =0.67 €/m2, ndersa te gjitha pozicionet e tjera jane jonormalsiht te uleta!!!

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “ARCH EMPIRE L.L.C.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “SHËRBI ME PROFESIONALE INXHINIERIKE -Ritender” me numër të prokurimit: “214-23-6903-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS

Hartimi i projekteve për nevoja të PK-se					
Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Cmimi për njësi	Shuma
A Hartimi i projekteve ideore - duke përfshirë edhe ingjizimin e gjendjes në teren. 10%					
1	Punimi i projektit ideor - arkitektura, organizimi dhe funksionaliteti i objektit.	m ²	1	0.22 €	0.22 €
2	Punimi i projektit ideor -faza e Statikës (konstrukcioni dhe stabiliteti i objektit)	m ²	1	0.02 €	0.02 €
3	Punimi i projektit ideor faza e Hidroinstalimeve -(rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit).	m ²	1	0.02 €	0.02 €
4	Punimi i projektit ideor faza e instalimeve elektrike - energjetika, instalimi i rrymave të dobëta dhe të forta, trufembrojtësit, alarmet elektronike kundër zjarrit, LAN,IT, TV, BMS, Video monitorimi, Interfonia.	m ²	1	0.02 €	0.02 €
5	Punimi i projektit ideor faza e instalimeve makinerike -- instalimet ngrohjes së objektit, stacionet termike, klimatizimi, ventilimi dhe instalime tjera makinerike.	m ²	1	0.02 €	0.02 €
6	Punimi i projektit ideor – RREGULLIMI I PARTEREVE / duke përfshirë edhe ingjizimin e gjendjes në teren.	m ²	1	0.02 €	0.02 €
TOTALI A :(1 deri 6)					0.32 €
B Hartimi i projekteve kryesore - palir - duke përfshirë edhe ingjizimin e gjendjes në teren. 50%					
1	Punimi i projektit kryesor - Arkitektura, organizimi dhe funksionaliteti i objektit.	m ²	1	0.45 €	0.45 €
2	Punimi i projektit kryesor - Konstrukcioni dhe stabiliteti i objektit (Ilogaria statike).	m ²	1	0.05 €	0.05 €
3	Punimi i projektit kryesor - Shkallevë emërgjente të objekteve nga konstrukcioni i çelikut apo betonit.	cope	1	0.02 €	0.02 €
4	Punimi i projektit kryesor të Hidroinstalimeve - ujësjellësi, kanalizimi.	m ²	1	0.02 €	0.02 €
5	Punimi i projektit kryesor të instalimeve elektrike - energjetika instalimi i rrymave të dobëta dhe të forta, trufembrojtësit, alarmet elektronike kundër zjarrit, LAN,IT, TV, BMS, Video monitorimi, Interfonia.	m ²	1	0.02 €	0.02 €
6	Punimi i projektit kryesor të instalimeve elektrike - Trafove.	cope	1	0.02 €	0.02 €
7	Punimi i projektit kryesor të instalimeve makinerike - instalimet ngrohjes së objektit, stacionet termike , klimatizimi, ventilimi dhe instalime tjera makinerike	m ²	1	0.02 €	0.02 €
8	Punimi i projektit kryesor të instalimeve - Ashensoreve të ndryshëm	cope	1	0.02 €	0.02 €
9	Punimi i projektit kryesor – RREGULLIMI I PARTEREVE. / duke përfshirë edhe ingjizimin e gjendjes në teren.	m ²	1	0.02 €	0.02 €
10	Punimi i projektit kryesor – Rrenimi i objekteve.	m ²	1	0.02 €	0.02 €
TOTALI B :(1 deri 10)					0.66 €

Po ashtu ky OE Eng Group shpk, ka ofruar cmim në poz a, pika C Hartimi i projekteve për renovim, çmim plotësisht të pakuptimt apo abuziv.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “ARCH EMPIRE L.L.C.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “SHËRBIME PROFESIONALE INXHINIERIKE -Ritender” me numër të prokurimit: “214-23-6903-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS

C	Hartimi i projekteve për renovim - duke përfshirë edhe inçizimin e gjendjes në teren.	10%			
1	Inçizimi detaj i objekteve ekzistuese (arkitektura), përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet ekzistuese, pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik.	m ²	1	1.80 €	1.80 €
2	Inçizimi detaj i objekteve ekzistuese-STATIKA, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet ekzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik.	m ²	1	0.02 €	0.02 €
3	Inçizimi detaj i objekteve ekzistuese-ELEKTRIKA, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet ekzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik.	m ²	1	0.02 €	0.02 €
4	Inçizimi detaj i objekteve ekzistuese-MAKINERIA, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet ekzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik.	m ²	1	0.02 €	0.02 €
5	Inçizimi detaj i objekteve ekzistuese-UJES/JELLES DHE KANALIZIMI, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet ekzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik.	m ²	1	0.02 €	0.02 €
6	Inçizimi i rrjetit të jashtëm të ujësjellësit, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet ekzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik.	M ¹	1	0.02 €	0.02 €
7	Inçizimi i rrjetit të jashtëm të kanalizimit, përpilimi i dokumentacionit teknik për objektet ekzistuese pa dokumentacion teknik apo me dokumentacion teknik.	M ¹	1	0.02 €	0.02 €
8	Punimi i projektit renovues – ARKITEKTURA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m ³	1	0.02 €	0.02 €
9	Punimi i projektit renovues – STATIKA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m ³	1	0.02 €	0.02 €
10	Punimi i projektit renovues – ELEKTRIKA, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m ³	1	0.02 €	0.02 €
11	Punimi i projektit renovues – HIDROINSTALIMET, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m ³	1	0.02 €	0.02 €
12	Punimi i projektit renovues – NGROHJA QENDRORE, ne projekt duhet te futen bazat e objektit ekzistues si dhe bazat e reja per renovim.	m ³	1	0.02 €	0.02 €
13	Punimi i projektit renovues të infrastrukturës – rrjet furnizues i ujësjellësit dhe përmbytjeve përcjellëse.	m ³	1	0.02 €	0.02 €
14	Punimi i projekteve renovues të infrastrukturës – rrjet i kanalizimit dhe përmbytjeve përcjellëse.	m ³	1	0.02 €	0.02 €
TOTALI C:(1 deri 14)					2.06 €

Egziston rreziku potencial qe ky OE te punoj vetem inçizimin e objektit per renovim te kërkoj aprovimin e ketyre matjeve -inçizimeve dhe te kërkoj pagesen per inçizimin detaj te Arkitektures se objekti egzistues (qe do ti takonte me ligj nese nenshkruhet kontrata) duke mos punuar fare me projektin kryesor per renovim. Pra, kjo menyre e ofrimit te cmimit eshte plotesisht abuzive dhe ne disproporcion te plote me cmimet e tregut. Per me teper OE Eng Group shpk ka ofruar cmime shume me te larte se poz. 3 dhe 4 pika H ku perfshihen elaboratet gjeodezike, e qe jane cmime dukshem me te larta se pozicionet e tjera. Te gjitha cmimet e tjera jane te dukshem se se jane cmime jonormalisht te uleta.

II Punimi i Elaborateve per nevoja te Autoritetit Kontraktues (Varesisht prej detyres projektuese/kerkesave) 5%					
1	Shqyrtime Gjeomekanike - Shpimet dhe studimet gjeomekanike dhe përgatitja e elaboratit gjeomekanik.	m ²	1	0.02 €	0.02 €
2	Shqyrtime Gjeomekanike - Shpimet dhe studimet gjeomekanike dhe përgatitja e elaboratit gjeomekanik.	m ²	1	0.02 €	0.02 €
3	Hartimi i Elaboratit per Matje gjeodezike.	m ²	1	2.45 €	2.45 €
4	Hartimi i Elaboratit per Matje gjeodezike.	m ²	1	3.60 €	3.60 €
5	Hartimi i Elaboratit per Akustike per objekte te ndryshme.	m ²	1	0.02 €	0.02 €
7	Hartimi i Elaboratit kunder zjarrit.	m ²	1	0.02 €	0.02 €
8	Hartimi i Elaboratit te Ambientit.	m ²	1	0.02 €	0.02 €
9	Projekti i shpronësimit (Elaboratet e shpronësimit)	ha	1	0.02 €	0.02 €
TOTALI H (1 deri 9) :					6.17 €

Pra, Ak duhet te beje vleresim ne baze te kriterëve qe vete ka aplikuar per te njejtin sherbim. Nese AK nuk bene vleresimin se keto dy OE kane aplikuar me cmime jonormalisht te uleta per arsye te cilat i cekem me larte, pra ka anuluar proceduren paraprake vetem per cmime jonormalisht te uleta pse nuk perdor te njetin kriter tani. Ne kete kerkese per rivleresim kerkojme nga AK ne perputhje me LPP-ne dhe Udhhezimet administrative te merr ne konsiderate cmimet jo normalisht te uleta dhe te elemeinoj te dy OE-te Eng group shpk dhe N.SH. GEO-MAP edhe per cmimet jonormalisht te uleta.

AK ne kete rast nuk ka aplikuar ligjin konkretisht Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët Andaj, përmes kërkeses Ankese Kerkojme nga Organi shqyrtues I Prokurimit ta shqyrtoj vendimin per anulimine kesaj procedure te prokurimit, ta anuloj kete vendim (marr parasysh ligjin dhe RROUPP-ne, sqarimet e lartecekura) te merr ne konsiderate sqarimet tona dhe të shpall njoftimin per vendimin e dhenies se kontrates grupit te OE te pergjegjshem me cmimin me te ulet qe ne kete rast eshte ARCH EMPIRE LLC dhe ENG IDEA shpk, sepse kemi ofertuar me çmime reale te tregut dhe jemi te pergjegjshem.

KRITERET PËR VLERËSIM

	<p>Kërkesa 5. Operatori Ekonomik duhet të ketë pajisje për matje gjeodezike GPS.</p>	<p>Dëshmia 5. <u>Certifikata e kalibrimit nga kompania e licencuar për kalibrim – valide.</u> Nëse OE e ka pajisjen në pronësi të veten duhet ta dëshmojë me deklaratë të nënshkruar dhe vulosur. Në rast e se OE nuk e ka në pronësi të veten pajisjen atëherë duhet ta ofrojë marrëveshjen për marrjen me qera ose marrëveshje për shfrytëzim. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me <u>validitet të kohëzgjatjes se kësaj kontratë e nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët.</u></p>	
--	---	---	--

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale:

- **IPE-PROING SH.P.K.** – nuk është i përgjegjshëm sepse: Të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit të bëra për këtë projekt në mes të OE dhe inxhinjerëve nuk janë të nënshkruara në mes të dy palëve, por janë të nënshkruara vetëm nga inxhinjerët e jo edhe nga OE.
- **" PROing&Partners " SH.P.K.** – nuk është i përgjegjshëm sepse: nga AK është kërkuar Një (1) Gjeodet i Licencuar me minimum përvojë pune 3 vite pas licencimit., kurse OE gjeodetin të cilin e ka ofruar nuk e përmbush këtë kriter (përvoja e punës pas licencimit).
- **N.SH. GEO-MAP** – nuk është i përgjegjshëm sepse: nga AK është kërkuar Një (1) Gjeodet i Licencuar me minimum përvojë pune 3 vite pas licencimit, kurse OE e ka ofruar licencën në emër të kompanisë e jo në emër të gjeodetit ashtu siq është kërkuar nga AK ne DT dhe në njoftimin për kontratë.
- **Grup i Operatorëve Ekonomik ARCH EMPIRE L.L.C.; ENG IDEA SH.P.K.** - nuk është i përgjegjshëm sepse: AK ka kërkuar që OE duhet të ketë pajisje për matje gjeodezike GPS. Të dëshmuar me Çertifikatë të kalibrimit nga kompania e licencuar për kalibrim – valide. Në këtë rast OE çertifikatën e kalibrimit nuk e ka ofruar valide.
- **" Enggroup " SH.P.K.** - nuk është i përgjegjshëm sepse: Te lista e çmimeve , totali i Pjesës D konkretisht tek çmimi për njësi me TVSH i peshuar vlera e totalit është O, çka nënkupton se për këtë pjesë nuk ka çmim të peshuar.

Vërejtje përmbyllëse në lidhje me vlerësimin e tenderëve të përgjegjshëm:

Komisioni i vlerësimit konstaton se për këtë aktivitet të prokurimit janë pranuar pesë (5) oferta të cilat janë vlerësuar nga ky komision. Pas ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të këtyre ofertave komisioni rekomandon që ky aktivitet i prokurimit të anulohet për shkak se asnjëra prej ofertave të pranura nuk ka qenë të përgjegjshme.

Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit: Altan Fejza
 Nënshkrimi: Altan Fejza
 Data: 27/09/2023

Titulli i kontratës: SHËRBIME PROFESIONALE INXHINIERIKE -Ritender

Nr. i Prokurimit:	214-23-6903-2-2-1
Nr i brendshëm	214/23/008/221

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave ² (€)
1	Enggroup " SH.P.K.	0.89 €
2	Grup i Operatorëve Ekonomik ARCH EMPIRE L.L.C.; ENG IDEA SH.P.K.	3.92 €
3	N.SH. GEO-MAP	1.32 €
4	" PROing&Partners " SH.P.K.	8.93 €
5	IPE-PROING SH.P.K.	15.44 €

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Policia e Kosovës anulon³ aktivitetin e prokurimit arsyetimin si në vijim: Asnjëra prej ofertave të pranura nuk janë të përgjegjshme.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - ARCH EMPIRE L.L.C.

Aktiviteti i prokurimit, lidhur me titull: “SHËRBIME PROFESIONALE INXHINIERIKE - Ritender” me nr. të prokurimit: “214-23-6903-2-2-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, ka publikuar njoftimin për kontratë me datën 17.07.2023, procedurë e hapur, hapja e ofertave është bërë me datë 27.07.2023, si dhe njoftimi mbi vendimin e AK-së është publikuar me datë 27.09.2023.

OE ankuesi pretendon se AK pa të drejtë ka anuluar aktivitetin e prokurimit, duke shkelë nenin 1, 2, 6, 59, 60, 61, 72 të LPP-së.

Tutje, OE ankuesi nuk pajtohet me eliminim e tyre, po ashtu parashtron pretendime edhe për Operatorët ekonomik Eng Group SHPK dhe NSH Geo-MAP, përkundër që AK ka eliminuar të njëjtit.

Pretendimi i parë:

OE ankuesi është eliminuar me arsyetimin:

Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:

- AK ka kërkuar që OE duhet të ketë pajisje për matje gjeodezike GPS. Të dëshmuar me Çertifikatë të kalibrimit nga kompania e licencuar për kalibrim – valide. Në këtë rast OE çertifikatën e kalibrimit nuk e ka ofruar valide.

Si dhe AK anulon aktivitetin e prokurimit me arsyen:

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Policia e Kosovës anulon³ aktivitetin e prokurimit arsyetimin si në vijim: Asnjëra prej ofertave të pranuar nuk janë të përgjegjshme.

Ekspertja Shqyrtuese sqaron se, AK operatorin ankues ka eliminuar për validitetin e

certifikatës, për të cilën I njëjti deklaron se është valide me afat deri dy vjeç, si e tillë, që të jem sa më objektiv në shqyrtimin e lëndës, fillimisht me datë 01.11.2023 kam kërkuar sqarim dhe konfirmim për validitet nga kompania e licencuar e cila ka lëshuar certifikatën e kontrollit, gjithashtu të njëjtën kohë kam kërkuar edhe nga AK që ta na argumentoj refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Tutje, me po të njëjtën datë 01.11.2023 kompania Ageo&CO ka kthyer përgjigje menjëherë duke na sqaruar se validiteti i certifikatës është dy vjeçare sipas kornizës së punës nr AKK 2020/01 për matje pika 20- certifikimi i instrumenteve gjeodezike, përgjigja më poshtë:

Pershendetje Blerina,

Uroj te jeni mire ju dhe punet ju shkojne mire!

Ne jemi distributor te autorizuar te prodhuesit internacional HI-TARGET dhe certifikata leshohet ne kuptim te nenit 20 te kornizes se punes 2020/01 te Agjencise Kadastrale te Kosoves, perkatesisht per licencim te gjeodetit ose kompanise gjeodeete.

Me shume detaje gjeni te bashkangjitur screen jpg per deshmi se jemi distributor dhe faqen e kornizes se punes ku citohet certifikimi i paisjeve.

Per cdo sqarim shtese mos hezitoni per kontakt.

Gjithe te mira,

AGEO & CO SH.P.K.

Kurse, nga AK me date 03.11.2023 kemi pranuar përgjigje lidhur me kërkesën për sqarim, ku të njëjtit janë përgjigjur si mëposhtë:

E nderuar,

Sa i përket pyetjes së parashtruar nga ekspertja e OSHP, ju njoftojmë se ne si komision i vlerësimit për këtë projekt lidhur me validitetin e pajisjes së GPS jemi bazuar në dokumentet e OE të tjerë pjesëmarrës në këtë tender, se kalibrimi i kësaj pajisje do të bëhet pas 12 muajsh për matje sa ma precize (bashkangjitur gjeni certifikatat e kalibrimit të GPS të OE tjerë pjesëmarrës). Ndërsa OE ARCH EMPIRE L.L.C ; ENG IDEA SH.P.K ka ofruar certifikatën e kontrollit/kalibrimit me dt.19.05.2022 që do të thotë se afati i kontrollit/kalibrimit ka qenë i skaduar para se të bëhet vlerësimi.

Me respekt,

Anetarët e komisionit te vleresimit

Si e tillë, ekspertja shqyrtuese konstaton se, pas pranimit të përgjigjeve nga kompania gjegjëse si dhe nga AK, konsideroj se OE ankuesi është i përgjegjshëm në këtë pikë, për faktin se, gjatë analizimit të **Kornizë të punës Nr. AKK 2020/01 për matje, krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale (parcelë, ndërtesë dhe pjesë të ndërtesës)**, [korniza-e-punes-per-matje-krijim-dhe-regjistrim-te-njesive-kadastrale.pdf \(rks-gov.net\)](#) si dhe konfirmimit të kompanisë së licencuar lidhur me validitetin e certifikatës së kontrollit konsideroj se certifikata është valide sepse është brenda dy viteve. Pra arsyeja e eliminimit

nga AK është i pa qëndrueshëm.

Kornizë të punës Nr. AKK 2020/01 për matje, krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale (parcelë, ndërtesë dhe pjesë të ndërtesës), pika 20:

20. Certifikimi i instrumenteve gjeodezike Për matje kadastrale mund të përdoren vetëm instrumente të certifikuar. Certifikimi i instrumenteve matëse duhet të bëhet nga institucioni apo kompania e autorizuar prej prodhuesit të instrumentit. **Vërtetimi/certifikatat për instrumentin nuk duhet të jetë më e vjetër se dy vite.** Instrumentet për matjet kadastrale të cilat duhet certifikuar janë: 1. Instrumentet GNSS dhe 2. Stacion Total. Gjeodetët e licencuar, kompanitë gjeode të licencuara dhe tekniku gjeodet i licencuar janë të obliguar që pas dy viteve pasi që është bërë certifikimi i instrumenteve, të njëjtën gjë ta përsërisin dhe certifikatën e re ta dorëzojnë në AKK tek komisioni për licencim. Në të kundërtën, d.m.th. nëse nga gjeodetët e licencuar, kompanitë gjeode të licencuara dhe tekniku gjeodet i licencuar nuk dorëzohet dëshmia për përsëritjen e certifikimit në afatin e caktuar, atëherë automatikisht konsiderohet e pezulluar licenca e tyre deri në plotësimin e kriterit të ri-certifikimit.

Tutje, OE ankuesi ka parashtruar pretendime edhe për Operatorët ekonomik **GEO-MAP N.SH** si dhe **ENG Group SHPK**.

Pretendimi i dytë:

AK ka elemnuar te gjithë OE-te me arsye te caktuara po ne do te ndalemi tek dy OE Eng group shpk dhe N.SH. GEO-MAP qe kane çmime dukshem me te lira se grup jone Arch Empire LLC dhe Eng Idea shpk. Po ju rikujtojme se vendimi për anulim i te njëjtës procedure prokurimi me titull: SHËRBIME PROFESIONALE INXHINIERIKE - Ritender, tani me eshte marr per here te trete nga AK, pra dy here me pare është anuluar kjo procedure e prokurimit per sherbime te lartecekura. Anulimi i kesaj procedure te prokurimit me date 21.06.2023 ka ndodhur mbeshtetur edhe ne vendimin e OSHP-se nr. 2023 0291. Arsyeja e anulimit te procedures se lartecekur eshte bere nga AK me aysen si me poshtë:

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Policia e Kosovës anulon³ aktivitetin e prokurimit arsyetimin si në vijim: Çmimet e peshuara të ofruara nga të dy OE kanë qenë çmime abnormalisht të ulta se çmimet e planifikuara e të peshuara nga AK.

Data: 02/05/2023

Emri dhe mbiemri i ZPP:

[Signature]

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e dytë sqaron, sa i përket vendimit me numër **2023/0291** pretendimi i OE ankuesit është i qëndrueshëm, për faktin se AK ka anuluar aktivitetin e prokurimit për arsye të çmimeve abnormalisht të ulëta.

Pretendimi i OE ankuesit:

U be i gjithë ky sqarim me siper pasi qe AK ne kete rast nuk ka marr fare ne konsiderate

cmimet jonormalisht te uleta te ofruar nga te dy OE-te Eng group shpk dhe N.SH. GEO-MAP. Ne njoftimin e vendimit te AK-se se te dates 27.09.2023 jane dhene arsyetimet e eliminimit te te dy OE te lartecur por nuk eshte perfshire fakti qe keta OE perveq arsyeve te dhena nga AK kane ofruar po ashtu çmime jonormalisht te ulet. Pas qasjes ne dokumentacion ku jane verifikuar dhe çmimet e ofruar nga te dy OE Eng group shpk dhe N.SH. GEO-MAP, perveq se vertetohet se kane ofruar çmime jonormalisht te uleta ne oferta e tyre ka dhe çmime abuzive. Sqarim: OE GEO MAP ne poz.1 Pika A Hartimi i projekteve ideore jep cmimin 5.00 € , ndersa te gjitha cmimet e tjera perfshi çmimet ne piken B hartimi i projekteve kryesore-palir ofron çmime jonormalisht të ulëta.

Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit te shkresave te lëndës sqaron se, në ofertën e OE Eng Group dhe GEO MAP gjenden paramasat.

Në pozicionet të cilat pretendon OE ankuesi që kanë vendosur çmime abnormalisht të ulëta ekspertja shqyrtuese sqaron se, pozicionet të cilat OE ankuesi i ka përmendur në ankesë janë po të njëjtat çmime të dhëna në paramasat e tyre, kurse sa i përket vlerësimit se a janë çmime të mirëqenë, konsideroj se AK gjatë procesit të rivlerësimit të hulumtoj dhe krahasoj të njëjtat, duke respektuar dispozitat ligjore të LPP-s, kurse vlenë të theksohet se arsyet e eliminimit të këtyre operatorëve ekonomik janë:

OE Enggroup SHPK:

Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:

- Te lista e çmimeve , totali i Pjesës D konkretisht tek çmimi për njësi me TVSH i peshuar vlera e totalit është 0 (zero), çka nënkupton se për këtë pjesë nuk ka çmim të peshuar.

OE GEO MAP N.SH:

Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:

- Nga AK është kërkuar Një (1) Gjeodet i Licencuar me minimum përvojë pune 3 vite pas licencimit, kurse OE e ka ofruar licencën në emër të kompanisë e jo në emër të gjeodetit ashtu siq është kërkuar nga AK ne DT dhe në njoftimin për kontratë.

Si përfundim, aktiviteti i prokurimit është anuluar me arsyetimin se, asnjë ofertë nuk është e përgjegjshme, gjerësa OE ankuesin ka eliminuar për certifikatën e kontrollit të cilën AK ka marrë si jo valide, mirëpo pas sqarimeve të kompanisë së licencuar si dhe pas verifikimit të kornizës së punës <https://akk.rks-gov.net/storage/app/media/Doracake%20profesional/korniza-e-punes-per-matje-krijim-dhe-regjistrim-te-njesive-kadastrale.pdf> pika 20, shihet se këto certifikata kanë validitet deri në dy vite, dhe si e tillë konsideroj se OE ankuesi sa i përket kësaj certifikate nuk mund të eliminohet, andaj sipas sqarimeve më lartë aktiviteti i prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim duke e anuluar vendimin e AK-së për anulim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**ARCH EMPIRE L.L.C.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**SHËRBIME PROFESIONALE INXHINIERIKE -Ritender**” me numër të prokurimit: “**214-23-6903-2-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**ARCH EMPIRE L.L.C.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**SHËRBIME PROFESIONALE INXHINIERIKE -Ritender**” me numër të prokurimit: “**214-23-6903-2-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **ARCH EMPIRE L.L.C.**



Blerina Huruglica